



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1301 Prot.
18

Tiranë, më 27/06/2019

VENDIM

Nr. 6 Datë 30/05/2019

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË UDHËZIMIN NR. 1, Datë 30.11.2017 “PËR PROCEDURËN E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË PROJEKTEVE QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK NDËRMJET DY VENDEVE”

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; si dhe të VKM Nr. 607 datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”,

Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, i mbledhur më datë 30.05.2019,

VENDOSI:

1. Në Udhëzimin Nr.1, Datë 30.11.2017 “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve” të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Në Pikën 6, Lidhja e Kontratës shtohet fjalia, si më poshtë vijon:

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT



ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

1. Vasil S. Tole, Anëtar

3. Elvin Gjevori, Anëtar

5. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Mynyr Koni, Anëtar

4. Bisej Kapo, Anëtare

6. Ines Muçstepa, Anëtare



“Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rezervon të drejtën e publikimit të rezultateve përfundimtare të projektit kërkimor si dhe publikimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit që në faza të hershme të tij. Institucioni përfitues ka detyrimin e publikimit të rezultateve përfundimtare të projektit kërkimor si dhe publikimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit që në faza të hershme të tij në revista shkencore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Përgjashtim përbëjnë rastet kur e drejta për publikimin e këtyre të dhënave konkurron me të drejta sensitive si: privatësia, sekreti tregtar, siguria kombëtare, interesat tregtare legjitime dhe e drejta e pronësisë intelektuale e palëve të treta.”

II. Në Aneksin II, Kontratë e përgjithshme për projekt kërkimi dhe zhvillimi në kuadër të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve shtohet pika 12 si më poshtë vijon:

“12. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka të drejtën e publikimit të rezultateve përfundimtare të projektit kërkimor si dhe publikimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit që në faza të hershme të tij. Institucioni përfitues ka detyrimin e publikimit të rezultateve përfundimtare të projektit kërkimor si dhe publikimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit që në faza të hershme të tij në revista shkencore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Përgjashtim përbëjnë rastet kur e drejta për publikimin e këtyre të dhënave konkurron me të drejta sensitive si: privatësia, sekreti tregtar, siguria kombëtare, interesat tregtare legjitime dhe e drejta e pronësisë intelektuale e palëve të treta.”

III. Në Aneksin III , Kontratë per financim vjetor shtohet pika 5 si më poshtë vijon:

“5. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka të drejtën e publikimit të rezultateve përfundimtare të projektit kërkimor si dhe publikimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit që në faza të hershme të tij. Institucioni përfitues ka detyrimin e publikimit të rezultateve përfundimtare të projektit kërkimor si dhe publikimin e të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit që në faza të hershme të tij në revista shkencore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Përgjashtim përbëjnë rastet kur e drejta për publikimin e këtyre të dhënave konkurron me të drejta sensitive si: privatësia, sekreti tregtar, siguria kombëtare, interesat tregtare legjitime dhe e drejta e pronësisë intelektuale e palëve të treta.”

2. Kopje të këtij vendimi, dy.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT



ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

1. Vasil S. Tole, Anëtar

3. Elvin Gjevori, Anëtar

5. Ejona Isufaj, Anëtare

2. Mynyr Koni, Anëtar

4. Bisej Kapo, Anëtare

6. Ines Muçstepa, Anëtare